



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

Pranuar me: Prilbjeno:		
24.06.2025		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
05-453/01-31334		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 24.06.2025

THIRRJE PUBLIKE PËR OJQ – të

Bazuar në Rregulloren e MF – NR-04 / 2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

1. Drejtoresha e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, (KLUBET SPORTIVE) me Seli në Komunën e Lipjanit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në lëminë e *SPORTIT në Komunën e Lipjanit*.

Ky institucion ofron mbështetje financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (KLUBET SPORTIVE) të regjistruara dhe të cilat bëjnë gara zyrtare me kategoritë për **Senior** në Federatat përkatëse.

2. OJQ-të (KLUBET SPORTIVE) në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte në lëmin e sportit dhe rekreacionit.

3. Organizatat jo-qeveritare (KLUBET SPORTIVE) mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në *Sporti në Komunën e Lipjanit*

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 56,500.00 euro.

Mjetet do të terhiqen nga kodi Subvencione për entitete jo publike

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 501.00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 15.000,00 euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 14.07.2025

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në një (1) nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është për 6 muaj.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të (KLUBET SPORTIVE) që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Lipjanit para datës së publikimit të thirrjes publike.

Klubet aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e sportit. KLUBET SPORTIVE duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtoratit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, KLUBI duhet të paraqesë prova se menaxheri i projektit nuk është nën hetime për vepra penale.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (www.komunaelipjanit-rks.org).

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për shërbim të qytetarëve , nr 3,

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: uran.qeriqi@rks-gov.net

Anila Reçica Llugini
Drejtoreshë e DKRS-së

